

Material për stukimin e pllakave të çimentos

Përshkrimi

JOINT-FILLER është një material plastik me bazë çimentoje, i përforcuar me fibra për stukimin e pllakave të çimentos. Ka përkulshmëri të lartë, rezistencë të lartë mekanike dhe ngjitje të shkëlqyer me nënshtresën. Mund të përdoret dhe të fërkohet lehtësisht. Ofron një sipërfaqe finale të lëmuar, të gatshme për veshje shtesë (bojë, pllaka etj.).

Fushat e përdorimit

JOINT-FILLER është e përshtatshëm për stukimin e fugave të bashkimeve të pllakave të çimentos, gjithmonë e kombinuar me rezistentët e alkalineve dhe shiritat me vetëngjitje të fibrave të xhamit. Ideal për izolim të plasaritjeve lokale të sipërfaqeve, poreve etj. I përshtatshëm gjithashtu për stukimin e vidave të mbërthimit të pllakave të çimentos.

Të dhënat teknike

| | |
|---|--------------------------------|
| Baza: | pluhur çimentoje |
| Ngjyra: | gri |
| Uji që nevojitet: | 4,50 kg për një thes 20 kg |
| Densiteti i volumit të llaçit të thatë: | 1,20 ± 0,20 kg/litër |
| Densiteti i volumit të llaçit të njomë: | 1,90 ± 0,20 kg/litër |
| Rezistenca në shtypje: | 16,00 ± 4,00 N/mm ² |
| Rezistenca në përkulje: | 5,50 ± 1,00 N/mm ² |
| Koha e punueshmërisë: | 4 orë në +23 ⁰ C |
| Temperatura minimale e përdorimit: | +5 ⁰ C |

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Pllakat e çimentos duhet të vendosen mirë dhe vidat e tyre mbërthese nuk duhet të dalin mbi sipërfaqe. Bashkimi duhet të jetë i pastër, pa pluhur, graso, grimca të lira etj. Përpara përdorimit të JOINT-FILLER, vendi i bashkimit duhet të laget plotësisht.

2. Përdorimi

JOINT-FILLER shtohet gradualisht në ujë, duke u trazuar vazhdimisht, derisa të krijohet një përzierje homogjene në punueshmërinë e kërkuar. Fillimisht, mbi vendin e bashkimit vendoset një shirit me vetëngjitje, rezistues ndaj alkalineve, prej fibrave të xhamit. Më pas, materiali hidhet në sipërfaqen e përgatitur më parë me një shpatull çeliku, derisa të mbushet i gjithë vendi i bashkimit.

Për izolimin e plasaritjeve lokale të sipërfaqeve, poreve etj, sipërfaqja duhet vetëm të stukohet

Pasi të thahet materiali, sipërfaqja smerilohet me letër smerile.

Konsumi

Rreth 100-150 g për metër linear të bashkuar.

Ambalazhimi

Thasë prej 20 kg.

Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim në kuti të izoluar është minimumi 12 muaj, në ambiente të thata.

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu